



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

1



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**DREJTORIA PËR EMERGJENCË DHE SIGURI**

**RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024**

**Dhjetor, 2024**

## 1. Hyrje

Menaxhimi i Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri është çështje shumë e ndjeshme e çdo shoqërie, mbrojtja dhe shpëtimi i njerëzve, të mirat materiale si dhe mbrojtja e ambientit është qëllimi kryesor i Komunës së Prizrenit. Andaj për këtë arsye gëzon kujdes të veçantë.

Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri aktivitetin e vet e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe fatkeqësitë tjera Nr.04/L-027, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr.04/L-012, Ligjin për Zjarrfikës dhe Shpëtim Nr.04/L-049, si dhe Udhëzimet Administrative.

DES-e pozicionin në Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime e ka dedikuar kryesisht për nevojat e Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtim, këto mjete janë shpenzuar në përputhje me planifikimin e paraparë për vitin 2024, për këtë shërbim.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri ka arritur të realizoj shumë detyra nga fusha e menaxhimit.

### Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri gjatë vitit 2024 ka realizuar këto projekte:

- ✚ *Është realizuar projekti për Vendosijen e Kamerave të sigurisë në Zonën Historike;*
- ✚ *Është realizuar projekti për vendosjen e Hidranteve në Zonën Historike;*
- ✚ *Është realizuar projekti për blerjen e dy motorrave Malor për brigadën e zjarrfikësve;*
- ✚ *Është realizuar Plani për “Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera;*
- ✚ *Ndërtimi i mureve mbrojtëse që paraqesin rrezikshmëri;*
- ✚ *Është realizuar fushata vetëdisuese për qytetarët;*
- ✚ *Janë mbajtur ligjerata nëpër shkolla nga Shërbimi i zjarrfikësve.*

## **Hartimi i planeve për performanc komunale**

1. **Vlerësimi i rrezikut nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera në Komunën e Prizrenit**
2. **Planet për reagime emergjente në nivel lokal**
3. **Hartimi i planeve për reagime emergjente:**
  - 3.1 Hartimi i planit operativ emergjent lokal.
  - 3.2 Hartimi i planit të evakuimit në shkolla.
  - 3.3 Hartimi i planit të evakuimit në objekte me rëndësi të veqanta.
  - 3.4 Plan i Drejtorinë Komunale për përballimin e emergjencave.
  - 3.5 Plan për reagim emergjent nga erozionet dhe rrëshqitjet e dheut.
4. **Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësit tjera:**
  - 4.1 Raporti i vlerësimi të dëmeve nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit tjera në Komunën e Prizrenit.
  - 4.2 Raporti i zjarrit në Parkun Nacional Sharri
5. **Raporti i Brigadës së zjarfikësve gjatë ndërveprimeve**
6. **Raporti i inspektorëve të Preventivës**

### Takimet - Inspektimet gjatë vitit 2024

- 🚩 **Janë mbajtur 6 -ë takime të rregullta me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBE);**
- 🚩 **Janë mbajtur takime të vazhdueshme me Organet e Sigurisë: Policinë e Kosovës, FSK-në, LMT-në, KFOR-in Turk;**
- 🚩 **Është bërë inspektimi i rrugës Prizren – Reçan;**
- 🚩 **Është bërë inspektimi nëpër shkollat;**
- 🚩 **Është bërë inspektimi i shtratit të Lumëbardhit, Reçan-Prizren.**

## Raporti i Njesisë Profesionale të Zjarrfikësve dhe Shpëtim

### Qëllimi - Misioni

NJ.P.Z.SH-ë ka për qëllim të merr masa në mënyrë që dëmet të jenë sa më të vogla gjatë intervenimeve, ti minimizojë apo ti eliminojë në tërësi si në vijim:

- ✓ Humbjet e jetëve të njerëzve,
- ✓ Të mirat materiale, si dhe
- ✓ Mbrojtjen e ambientit.

Fatmirësisht gjatë vitit 2024 është arritur ky qëllim falë profesionalizmit të strukturës organizative të zjarrfikësve të NJ.P.Z.SH.

### Në vitin kalendarik 2024

Në shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtim janë paraqitur gjithsej **703-të raste emergjente**, ku Shërbimi i Zjarrfikësve ka intervenuar me ekipet e veta, duke i dalë në ndihmë qytetarëve për t'i minimizuar dëmet materiale në pronat shoqërore apo private si dhe shpëtimin e jetëve të qytetarëve.

- **586** - të intervenimeve janë për shuarjen e zjarreve, ndërsa
- **117** - të intervenime teknike emergjente të llojeve të ndryshme.

## 4 Maj Dita e Zjarrfikësve



### Njësia Profesionale e Zjarrfikësve në PRIZREN Numri i zjarreve – Janar – Dhjetor viti 2024

Zjarret - realizimi i numrit të përgjithshëm i daljeve Janar - Dhjetor 2024																					
K O M U N A  E P R I Z R E N I T	Muaji	Nr.zjarreve	Zjarr-Shtepi Banimi	Zjarr në Obj. Kolek (banesa)	Zjarre në Depo afariste	Zjarret në Hotele	Zjarr në Ushqim Bagëtish	Lokale Afariste Podrume	Obj.Administrative	Zjarr në Shtyll Elektrike	Zjarr-në Mbeturina	Zjarre Fushore	Zjarre Malore	Zjarre në Automjete Vetur	Zjarre në Ogjaqe	Zj.në Orë dhe paisje elektrike	Zjarr në Kablo Elektrike	Zjarr ne Trafo Stac.	Jo i sakt-genjeshter	Totali	
	Janar	24	4	-	-	-	1	1	-	3	3	1	1	1	3	2	2	2	2	-	24
	Shkurt	49	2	-	-	-	2	-	-	5	6	16	14	1	-	1	1	1	1	-	49
	Mars	35	3	-	-	-	-	-	-	5	7	5	6	4	3	1	-	1	1	1	35
	Prill	24	2	1	-	-	-	-	-	-	7	4	5	-	-	2	2	2	1	-	24
	Maj	12	5	-	1	-	-	-	-	-	-	1	2	-	2	-	-	-	1	-	12
	Qersho	41	3	1	-	-	-	2	-	-	5	17	3	2	-	1	5	2	2	1	41
	Korrik	98	3	1	1	-	-	-	-	5	19	51	9	4	-	1	3	1	1	4	98
	Gusht	151	7	2	-	-	-	1	-	2	11	91	28	3	-	2	3	1	1	2	151
	Shtator	58	2	1	-	-	-	1	-	-	5	33	12	2	-	1	1	-	-	-	58
	Tetor	18	2	-	1	-	-	1	1	4	6	-	-	1	-	-	1	1	1	-	18
	Nëntor	27	5	-	3	-	-	-	1	4	2	-	1	2	1	3	4	1	1	-	27
	Dhjetor	43	5	2	1	-	-	1	-	11	1	-	-	1	2	2	14	3	-	-	43
<b>Total:</b>	<b>586</b>	<b>42</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>-</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>31</b>	<b>72</b>	<b>220</b>	<b>79</b>	<b>22</b>	<b>9</b>	<b>16</b>	<b>27</b>	<b>16</b>	<b>6</b>	<b>586</b>		

Tabela 1.1 zjarret

### Njësia Profesionale e zjarrfikësve në PRIZREN Intervenime Teknike - 2024

Intervenime teknike (sherbime) realizimi i numrit të përgjithshem i daljeve Janar – Dhjetor 2024															
K O M U N A  E  P R I Z R E N I T	MUAJI	Nr. Rasteve	Akcidente komunika. Rrugor ART	Int.Teknik pastrimi pas aksidentit ART	Int.Teknik Shpetimi i personave	Int.Teknik Thithja e ujit	Int.Teknik Furnizim me ujë	Mbyllja- tërheqje bombolese se gasit- Pijinit	Int.Teknik -Hapja e baneses ashensorit	Zbraz.e lënd. ndezëse	Rrënim shtëpis,erozion	Tërheqje- Shpetimi i kafesheve	Tjera	Totali:	
	Janar	3	-	2	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	3
	Shkurt	6	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	5	-	6
	Mars	9	2	2	1	-	-	-	-	-	-	-	3	-	9
	Prill	8	-	1	-	5	-	-	-	-	-	-	2	-	8
	Maj	6	-	2	-	-	-	-	2	-	-	-	2	-	6
	Qershor	6	1	1	-	-	-	1	3	-	-	-	-	-	6
	Korrik	23	-	5	1	1	2	-	5	2	-	-	4	3	23
	Gusht	13	1	6	2	1	2	-	-	-	-	-	1	-	13
	Shtator	9	-	4	-	-	2	1	1	-	-	-	-	1	9
	Tetor	11	2	1	-	2	-	-	-	-	-	-	3	3	11
	Nëntor	15	-	1	3	-	1	1	-	-	4	-	-	5	15
	Dhjetor	8	1	2	3	-	1	-	-	-	1	-	-	-	8
<b>Total:</b>	<b>117</b>	<b>6</b>	<b>28</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>14</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>15</b>	<b>17</b>	<b>117</b>		

Tabela: 1.2 Intervenimet teknike



### Zjarret në “Parkun Nacional Sharri”



### Raport i shkurtër: Parku Nacional Sharri

**Nga data:** 05-08-2024 (e hënë ) deri më datë 18-08-2024 (e premte).

**Vendi:** Kosovë

**Lokacioni :** Prizren-Prevallë (42.1785672 - 20.9629524)

**Si pasojë e zjarreve të shkaktuara në “Parkun Nacional Sharri” në Prevall me datë 11-08-2024 është ngritur shtabi emergjent duke u bazuar në “Planin e Reagimit Kombëtar” i përbërë nga:**

- ✓ **Drejtoria për Emergjncë dhe Siguri**
- ✓ **Policia e Kosovës**
- ✓ **Urgjenca**
- ✓ **Drejtoria e Parkut Nacional Sharri**
- ✓ **Brigada e Zjarrfikësve**

**Në këtë incident kanë marrë pjesë të gjitha organet e sigurisë: DES, Brigada e Zjarrfikësve, Parku Nacional Sharr , PK, FSK, KFOR-ri, AME, MPB, dhe MMPHI.**

Me datë 16.08.2024 përfaqësuesit e shtabit emergjent, Flamur Hoti Komandant i Incidentit, Nexhdet Mrasori Komandant i Policisë, Ramize Shala Drejtoresh për Emergjncë dhe Siguri, Zyrtar të Parkut Nacional Sharr dhe KFOR-i kanë bërë inspektimin e fundit të terrenit dhe pas inspektimit është marrë vendimi që të përfundoj misioni në Prevall dhe është shpërbërë Shtabi Emergjent.

**Gjatë këtij intëvenimi janë shpenzuar 12.000L ujë me shpinore dhe 11.000L ujë me rrjet të shtrirë gjithsejt 23.000L ujë.**

**Të gjitha shpenzimet derivatet, paisje dhe logjistikën i ka mbuluar Komuna e Prizreni**

**Informata shtesë:**

**Gjatë gjithë kohës janë mbajtur të informuar:**

**Kryetari - Shaqir Totaj**

**Zv.Ministri MPB-së - Blerim Gashani**

**Kryeprokurori - Admir Shala**

**Organet e Sigurisë - Policia e Kosovës**

**UD.Drejtori AME - Shefki Avdullahu**

**Drejtori i zjarrfikësve të Kosovës - Nexhat Behrami**

**Lëndimet e personelit:**

**4 zjarrfikës**

**2 ushtarë të FSK-së**

**Të gjitha këto informacione janë të dokumentuara me shkrim dhe me fotografi poashtu janë edhe provat në vendin e ngjarjes.**

## Dëmet e shkaktuara nga Fatkeqësit Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera

- ✚ Gjatë vitit 2024 ka pasur dëme nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësit Tjera në bujqësi dhe në ekonomi familjare ku komisioni ka përpiluar raportin.



### Ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe eliminimi i rrezikshmërisë



## Qëllimi dhe objektivat e Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri

---

- ✓ Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri në periudhën e ardhshme synon që të rrisë kapacitetet dhe cilësinë e punës në teren dhe njohten e punës së teknikave të reja sipas standardeve Europiane.
- ✓ Siguri për jetën dhe mbrojtjen e pasurisë të qytetarëve në Komunën e Prizrenit, në mënyrë që të parandalohim çfarëdo rreziku që i kanoset qytetari.
- ✓ Parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të aksidenteve dhe zvogëlimi i rasteve të viktimave.
- ✓ Vendosja e kamerave të sigurisë në qytetin e Prizrenit, vendosja e kamerave në hyrje dhe dalje të autostradës si dhe vendosja e kamerave në fshatra.
- ✓ Planit i vlerësimit të rrezikut për Komunën e Prizrenit.
- ✓ Hartimi i planit të evakuimit në shkollë
- ✓ Trajnimi i zjarrfikësve dhe përfaqësues të lagjeve dhe fshatrave për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera.
- ✓ Përmirësimi i kushteve të punës për zjarrfikësit.
- ✓ Përgatitja e ushtrimeve fizike të zjarrfikësve, demonstrimi dhe aftësitë e tyre.
- ✓ Hapja e detyrë të Administratës dhe hartimi i planit për evakuim në raste Emergjente.
- ✓ Bashkëpunimi me Institutionet e sigurisë (FSK-në, Policinë etj.).
- ✓ Rritja e subvencioneve.

Msc. Ramiza Sinaqaj-Shala

Drejtoreshë për Emergjencë dhe Siguri

